


Shkaqet e trafikimit

Shkaqet



Duke parë faktorët e kërkesave dhe ofertave që ushqejnë përhapjen e trafikimit, mund të dallojmë disa nga shkaqet e këtij fenomeni sipas të dhënave social-kulturore, ekonomike dhe politike të jetës.

Aspektet e kërkesave

Social – Kulturore

- **Analfabetizmi** dhe mundësitë e papërshtatshme të arsimimit dhe të punës; mungesa e perspektivës së edukimit.
- **Patriarkaliteti**, që është shkaku kryesor i diskriminimit të grave dhe fëmijëve.
- **Heqja e të drejtave familjare tradicionale**, dhe kërkimet e konsumimit nxisin shitjet e grave dhe të fëmijëve.
- **Diskriminimi racia**, racizmi dhe intoleranca që lidhet me to i bën gratë e këtyre bashkësive më të brishta ndaj trafikut.
- **Teknologjitë e reja dhe mediat**, që me publicitetin dhe me tregtimin e seksit prezantojnë trupin e femrave vetëm si objekt për kënaqësi seksuale.

Aspektet e ofertave

Social – Kulture

- **Kujdesi mashkullor** dhe perceptimi i grave në shoqëri, dhe pabarazia në kushtet social – ekonomike femërore.
- **Pornografia** dhe roli i saj në shtimin e kërkesës së seksit. Asaj i lidhet edhe përdorimi gjithnjë e në rritje i Internetit si mjet i tij dhe mjet i përdorur nga trafikantët për tregtimin e grave dhe fëmijëve.
- **Patriakaliteti**, që shkakton marrëdhëniet e pushtetit ndërmjet burrit dhe gruas, dhe diskriminimin e këtyre të fundit.
- **Sjellja konsumiste**, shkëmbimi dhe tregtimi i seksit, i cili bën që trupi femëror të konsiderohet si mall dhe si objekt për kënaqësi seksuale.

Ekonomike

- **Pabarazitë ekonomike** në brendësi të vendit, dhe midis kombeve dhe krahinave, është një nga shkaqet kryesore të rritjes së trafikimit të grave.
- **Femërizimi i varfërisë**, meqë 70% e të varfërve të botës janë gra dhe ato mbajnë familjet e tyre me punë të pasigurta në sektorin jo të rregullt.
- **Globalizmi**, dhe ndikimi i tij dallues mbi gratë me ristrukturimin dhe kalimin ekonomik dhe me shpenzimet sociale që u përkasin grave.
- **Ekonomia e lirë**, që ngadalëson kontrollet dhe hap kufijtë, duke lehtësuar mobilizimin e popullsisë dhe imigrimin klandestin.
- **Një biznes fitimdhënës**: sepse gratë shiten dhe rishiten shumë herë. Dhe për më tepër ka më pak rrezik të arrestohen dhe kjo gjë tërheq organizatat kriminele.
- **Rënia e regjimit komunist në Evropën qendrore dhe në Evropën e lindjes**, dhe vështirësitë ekonomike të periudhës kalimtare.



Politike

- **Migracioni femëror ndërkombëtar**, me gratë që hyjnë në tregun e punës, dhe mungesa e rregullave të migrimit për punë që furnizojnë mundësitë e mëdha për rrugët e trafikimit.
- **Konfliktet ushtarake dhe civile**, që i shtyjnë njerëzit të ikin nga vendet e tyre. 80% e 25 miliona refugjatëve në të gjithë botën janë gra dhe fëmijë, pre e lehtë për trafikantët.
- **Shtimi i krimit transkombëtar** dhe përhapja e rrjetit të trafikut të drogës janë burime të formave të tjera të shfrytëzimit.
- **Mekanizmat e aplikimit** të ligjit dhe parandalimet kundër shkelësve të ligjit janë të pa efektshme.
- **Korrupsioni** i policisë, i funksionarëve dhe i paqësorëve.

Ekonomike

- **Kërkesa e punëdhënësve** në një treg pune jo të kualifikuar dhe që kushton pak. Puna femërore është zakonisht në një nivel të ulët dhe kryhet në ambientet shtëpiake, në sektorin e lokaleve të natës dhe në atë jo të rregullt.
- **Industria e tregtimit të seksit** në përhapjen dhe shtimin e kërkesës së seksit. Gratë dhe fëmijët tregtohen në mënyra të ndryshme: me anën e prostitucionit, trafikimit të seksit, turizmit seksual, me nuset e shitura me anë të postës, në klubet e natës me striptizëm, në baret ku kërcëhet gjysmë të zhveshura e kështu me radhë. Përhapja e shfrytëzimit seksual fëmënor preferohet nga klientët meshkuj, për gratë e reja dhe vajzat, për shkak të frikës të marrjes të virusit HIV.
- **Planet e zhvillimit** që nxisin turizmin dhe modelet e zhvillimit që varen nga punëtorët emigrantë.

Politike

- **Bazat ushtarake** e të shkuarës dhe këto të sotmet kanë krijuar një infrastrukturë të madhe për prostitucionin.
- **Raportet politike dhe ekonomike jo të njëjta të bazuara mbi shfrytëzimin**, të vendosura nga Veriu shkaktojnë keqësimin e kushteve të jetesës në Jug.
- **Planet e emigracionit kufizues**, kanë zvogëluar mundësitë e emigrimit të rregullt.

- **Shitjet e armëve**, dhe rritja e konflikteve brenda vendit ose ndërmjet kombeve rrit numrin e refugjatëve që bien pre e trafikimit.
- **Mekanizmat** e aplikimit të ligjit dhe marrjet e masave kundër shkelësve të ligjit janë të pa efektshme.




Pyetje për laboratorin

1. Nga përvoja juaj, çfarë shkaqesh të tjera mund të përfshihen në:
 - (a) aspektet e ofertave: social – kulturore, ekonomike dhe politike?
 - (b) aspektet e kërkesave: social – kulturore, ekonomike dhe politike?
2. Shqyrtoni shkaqet e identifikuar në listë dhe përshkruani hollësisht ndikimin e tyre mbi gratë dhe fëmijët.
3. Deri në cilën pikë patriakali është një nga shkaqet kryesore që kontribon në trafikimin e grave dhe të fëmijëve?
4. Shqyrtoni efektin e mediave dhe të teknologjive të reja në lidhje me tregtimin e trupave femërore.

Mekanizmat dhe teknikat e trafikimit

Rrjetet e trafikimit

- Janë shumë të përhapura, të gërshetuara, veprojnë në mënyrë klandestine dhe shpesh janë jashtë rrezes së veprimit të rregullit gjyqësor.
- Ndryshojnë vazhdimisht dhe shpesh ndjekin modelet e emigrimit.
- Janë të vështira për t'u dalluar – trafikantët janë ekspertë: nuk zbulohen nga të tjerët dhe shmangin arrestimet.
- Janë të fshehur mirë – viktimat e trafikimit janë klandestinë, kështu që qëndrojnë në heshtje dhe të fshehura nga frika e kërcënimeve të trafikantëve dhe kthimit në atdhe.
- Përfitojnë nga bashkëpunimi i gjerë i funksionarëve të shteteve të korruptuara.
- Përkrahen nga përparimet që ka bërë teknologjia (telefoni, faksi, interneti) me anë të të cilave zgjerojnë xhiron e biznesit në nivel ndërkombëtar, dhe përdorin teknologjitë e reja të komunikimit dhe informacionit për të blerë, shitur dhe shkëmbyer lehtësisht me miliona imazhe dhe video.
- Janë organizata joligjore të mafies që veprojnë në vendet e origjinës, transite dhe të vendmbërritjes.



Njerëzit kyçë

Shumë persona janë të përfshirë në xhiron e trafikimit: duke filluar nga ai që gjen dhe bind gratë dhe fëmijët, deri tek ai që i zhvendos nga një vend në tjetrin:

- Agjentët e rrjetave
- Operatorët turistikë dhe agjencitë e udhëtimeve (aktivitetet e mbulimit)
- Agjentët e sistemimit
- Shefat dhe gangsterat e trafikimit
- Shoqatat kriminele të shumë vendeve
- Pronarët e bareve dhe gratë e vendit, që kapin viktimat e trafikimit.
- Prindërit, të afërmit dhe miqtë
- Mësuesit

- Banorët dhe shefat e një fshati
- “Mamans“, pronarët e shtëpive publike
- Tutorët dhe ata që gjejnë viktimat e trafikimit
- Klientët dhe pronarët e bareve
- Funkionarët e korruptuar (policia, dogana, paqësorët, ai që është roje në kufi).

Disa teknika të trafikimit

- Kontaktet vendase: trafikantët shërbehen nga personat e vendit dhe banorët e fshatit për të dalluar familjet vulnerabël. Ata kontaktojnë gratë dhe fëmijët e pavetëdijsëm në stacionet hekurudhore dhe në stacionet e makinave.
- Shitja e drejtpërdrejtë: gratë dhe fëmijët shiten nga prindërit ose nga familjarët e tjerë.
- Tallja: njerëz pa skrupuj mashtrojnë prindërit dhe bindin gratë dhe vajzat duke u premtuar në mënyrë të rreme punë të paguar mirë ose martesë me persona të pasur.
- Skllavëria për shkak të borxheve: nxitjet ekonomike për familjet dhe paktet e tjera e marra i shtyjnë fëmijët dhe gratë e reja në skllavërinë seksuale ose në punët e tjera të bazuar në shfrytëzim; por klauzolat e këtyre borxheve nuk janë të caktuara mirë.
- Rrëmbimi: gangsterët kriminalë ose ndërmjetësit, rrëmbejnë gratë dhe fëmijët, i detyrojnë të punojnë dhe shpesh ua shesin shtëpive publike.
- Falsifikimi i dokumenteve: dokumentet dhe pasaportat false e bëjnë të vështirë dallimin dhe gjetjen e viktimave të trafikimit.
- Tangjentet: u paguhet funksionarëve ose policisë për të marrë dokumentet false, ose kur kalojnë kufijtë.
- Transporti: gratë dhe fëmijët transportohen në këmbë, me motoçikleta, me furgonë ose tragete.

Pyetje për laboratorin

1. Nga historitë dhe informacionet e mbledhura deri tani, a mund të nxirrni një profil të atij që trafikon gratë dhe fëmijët? A jeni të habitur nga ajo që keni mësuar?
2. Cilët janë faktorët kyçë sipas bazës së trajtimit të grave dhe fëmijëve si mall?
3. Pse trafikimi konsiderohet një formë moderne e skllavërisë?
4. A jeni në dijeni mbi grupet mafioze që veprojnë në vendin tuaj në rrjetin e trafikimit?
5. Në lidhje me problemin e trafikimit, cilat janë burimet e korrupsionit që duhen demaskuar, dhe si mund të bëhet kjo gjë?

SHËNIME